



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 236, Datë 05.11.2024

MBI

**DHËNIEN E GARANCISË SË ORIGJINËS PËR ENERGJINË ELEKTRIKE TË
PRODHUAR NGA PARKU FOTOVOLTAIK “BLUE 1”, I SHOQËRISË “SPV BLUE 1”
SH.P.K., PËR MUAJIN GUSHT 2024**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22 të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; neneve 7 dhe 11 të Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, miratuar nga bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me vendimin nr. 229, datë 20.12.2019, i ndryshuar; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, i ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 05.11.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1912/4 prot., datë 04.11.2024, të Drejtorisë së Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme të Energjisë “Mbi dhënie e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar në muajin Gusht 2024 nga parku fotovoltaik “BLUE 1” i shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k.”,

Konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1912 prot., datë 13.09.2024, shoqëria “SPV BLUE 1” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për pajisjen me Garanci të Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga parku fotovoltaik “Blue 1”, për muajin Gusht 2024. Referuar kësaj kërkesë sasia e energjisë elektrike të prodhuar gjatë periudhës 01.08.2021 – 31.08.2024 është 13543.22 MWh.
- Shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. është pajisur me certifikatë të garancisë së origjinës për sasinë e energjisë elektrike të prodhuar nga impianti fotovoltaik “BLUE 1” në muajt Qershor 2024 dhe Korrik 2024, respektivisht me vendimet e bordit të ERE nr. 158, datë 31.07.2024 dhe nr. 189, datë 12.09.2024.
- Referuar nenit 14.2 të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, të ndryshuar, pas lëshimit të certifikatës së parë të garancisë së origjinës, çdo aplikues që paraqet në ERE një kërkesë për Certifikatë Garancie Origjine do të depozitojë për qëllime të këtij aplikimi vetëm dokumentacionin që ka pësuar ndryshim referuar kërkesave të nenit 7, të kësaj rregulloreje.

- Në kërkesën e paraqitur, shoqëria bën me dije se dokumentacioni fillestar i depozituar në ERE për pajisjen me certifikatën e garancisë së origjinës nuk ka ndryshuar.
- Në vijim të kërkesës së paraqitur nga shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k., mbështetur në përcaktimet e pikës 6 të nenit 22 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE me shkresën nr. 1912/1 prot., datë 30.09.2024, i është drejtuar Operatorit të Sistemit të Transmetimit “OST” sh.a., me kërkesën për informacion për sasinë e energjisë elektrike faktike të prodhuar nga ky impiant, për periudhën 01.08.2024 – 31.08.2024.
- OST sh.a. me shkresën nr. 6621/2 prot., datë 11.10.2024, protokolluar në ERE me nr. 1912/3 prot., datë 15.10.2024, ka bërë me dije se sasia e energjisë së prodhuar bruto për periudhën 01.08.2024 – 31.08.2024 është 13543.22 MWh.
- Të dhënat e ardhura nga OST sh.a., janë të njëjta me ato të paraqitura nga shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. dhe sasia prej 13,543 MWh do të merret në konsideratë për lëshimin e Garancisë së Origjinës, në zbatim të përcaktimeve të pikave 11.2 dhe 11.3 të Rregullores ku parashikohet se Garancia e Origjinës lëshohet për një njësi të energjisë elektrike 1 MWh.
- Në referencë të përcaktimeve të nenit 22, pikës 5 të ligjit nr. 24/2023, *Garancia e origjinës është e vlefshme për një vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e Garancisë së Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga parku fotovoltaik “Blue 1”, i shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k., për periudhën 01-31 Gusht 2024, për sasinë 13,543 MWh.
2. Garancia e origjinës, e dhënë sipas përcaktimeve të këtij vendimi, është e vlefshme për 1 (një) vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.
3. Drejtoria e Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme të Energjisë, të njoftojë shoqërinë “SPV BLUE 1” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI